



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.85, datë 28.04.2022

**PËR SHPALLJEN E VENDIT VAKANT TË DREJTUESIT NË PROKURORINË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË NËPËRMJET
PROCEDURËS SË NGRITJES NË DETYRË**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 52 pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e vendit vakant për Drejtues prokurorie, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Njoftimi i vendit vakant si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët, publikohen në faqen zyrtare të institucionit, jo më vonë se një javë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më datë 28.04.2022.

KRYETAR

ALFRED BALLA

